



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 27.11.2024

Nr: 201

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË SELENICË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË ALEANCA
DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË”, Z. ROBINI FATMIR HODAJ

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 2032 prot., datë 4.10.2024, këshilli i bashkisë Selenicë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Sokol Petref Hodaj, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, 1and 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Aleanca Demokratike e Shqipërisë për këshillin e bashkisë Selenicë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 5, z. Robini Fatmir Hodaj.

Me shkresën nr. 2931/1, prot., datë 25.10.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Selenicë, z. Robini Fatmir Hodaj, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Data: 27.11.2024 Nr:201
Ora:11:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Selenicë “me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Aleanca Demokratike e Shqipërisë”, z. Robini Fatmir Hodaj”

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Aleanca Demokratike e Shqipërisë ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër VL-AD-7750_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Robini Fatmir Hodaj, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 3143 prot., datë 4.11.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3142 prot., datë 4.11.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Robini Fatmir Hodaj.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 12078/1 prot., datë 12.11.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar z. Robini Fatmir Hodaj, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr.17502/1 prot., datë 11.11.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Robini Fatmir Hodaj, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Robini Fatmir Hodaj, në këshillin e Bashkisë Selenicë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në këshillin e Bashkisë Selenicë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Aleanca Demokratike e Shqipërisë, z. Robini Fatmir Hodaj.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI